



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 2 shkurt 2015, në mbledhjen e XIII-të
(trembëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuçi, Fidan Rekalju, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Haki Rudari, theksoi, përkundër faktit se kjo mbledhje është e ngarkuar me shumë pika të rendit të ditës, konsideroj se një çështje është e vonuar dhe në rend dite do duhej të përfshihet edhe Informata për gjendjen në arsim duke u bazuar në faktin se kemi një numër të madh të nxënësve të cilët e braktisin shkollimin për shkak të emigrimit, andaj do të ishte mirë që në cilësinë e këshilltarëve të informohemi nga Drejtoria e Arsimit për numrin e nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me çështjen e shtruar nga parafolësi ju njoftoj se këshilltari z. Lutfi Rexhepi, ka kërkuar të dhënat për numrin e nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin për shkak të emigrimit, andaj Informata përkatëse në mënyrë tabelore do t’iu jepen të gjithë këshilltarëve para fillimit të mbledhjes së Kuvendit dhe konsideroj se për këtë çështje nuk do duhej të bëhet debat.

z. Naim Çunaku, theksoi, lidhur me çështjen e shtruar do duhej të qartësohet se a do të paraqitet informatë, për të cilën nuk do të ketë debat, apo raport ku do të

debatohet për gjendjen e krijuar në arsim për shkak të emigrimit të nxënësve dhe braktisjes së tyre të shkollimit.

z. Haki Rudari, theksoi, në pikën e dhjetë të rendit të propozuar të ditës është, Informatë e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës, andaj shtrohet pyetja përse si pikë e veçantë e rendit të ditës mund të jetë informata e një komisioni e nuk mund të jetë informata për një çështje shumë të ndjeshme.

Në vazhdim, pas votimit u konstatua se rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me rekomandim që para fillimit të mbledhjes së Kuvendit, këshilltarëve t'iu shpërndahet Informata në formë të shkruar për numrin e nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin për shkak të emigrimit.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 29 dhjetor 2014

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, theksoi, në faqen e dytë të Ekstraktit të procesverbalit, në fillim të diskutimit tim duhet të shtohet, e mbështes në parim, që ka të bëjë me çështjen e ndihmës financiare të lehonave.

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me vërejtjen e parafolësës.

3. Propozimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës

➤ Raporti nga debati publik lidhur me propozimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën e hyrjes, përkatësisht Raportin për zbatimin e diskutimit publik.

z. Kadri Avdiu, theksoi, vërejtja ime konsiston në atë që me këtë propozim të Rregullores nuk janë përfshirë të gjitha fshatrat kur dihet se mbeturina ka edhe në varreza që është shumë brengosëse, andaj konsideroj se duhet shqyrtuar mundësitë që të përfshihet grumbullimi i mbeturinave edhe në fshatra.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mbi bazën e bisedave që i kam pasë me disa banorë të fshatit Metehi jam informuar se ata qytetarë janë të interesuar ta zgjidhin çështjen e grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave mirëpo nuk ishin në dijeni se në çfarë mënyre duhet vepruar, përkatësisht se a duhet komuniteti t'i drejtohet Kompanisë përkatëse apo Kompania t'i paraqet ofertën komunitetit të vendbanimit apo fshatit të caktuar.

z. Haki Rudari, theksoi, në parim e mbështes këtë propozim të Rregullores, mirëpo konsideroj se lidhur me këtë çështje do duhej të kishte më shumë debat me qytetarë e në veçanti debat nëpër shkolla ngase një prej vendeve që ka mbeturina janë hapësirat rreth shkollave, andaj propozimi im është që shkollat të pajisen me kontejnerë.

z. Faik Muçiqi, theksoi, sa i përket zgjerimit për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave jashtë qytetit dhe nëpër fshatra, kontratat i bënë kompania në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarë, rasti i fundit është fshati Bellopojë ku qytetarët i kanë mbledhur afro 50 nënshkrime dhe së shpejti shërbimet përkatëse do të ofrohen edhe në atë mjedis.

Mirëpo do theksuar se për zgjerimin e ofrimit të këtyre shërbimeve problem paraqet fakti se Kompania regjionale nuk ka mekanizëm të mjaftueshëm, pra nuk kemi ndonjë kompani tjetër alternative në mënyrë që për territore konkrete të caktoheshin kompani përkatëse.

U përmend edhe çështja e debatit me qytetarë lidhur me këtë propozim të Rregullores, jo vetëm në këtë rast por në përgjithësi në debate publike pjesëmarrja e qytetarëve është mjaftë e vogël, e pjesëmarrja është edhe më e vogël kur ka të bëjë me çështje specifike siç është rasti konkret ku të interesuar kanë qenë vetëm disa përfaqësues të kompanive.

Pas votimit u konstatua se propozimi i kësaj Rregulloreje Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozimi i Vendimit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i informuar se në 90% të Bashkësive të fshatrave në debate me qytetarë kanë qenë vetëm anëtarët e Komiteteve të fshatrave, pajtohem me këtë mirëpo është e papranueshme që kryetarët e Komiteteve të fshatrave të emëruar prej Komune, nuk i kanë informuar qytetarët e subjekteve tjera politike, andaj në këto rrethana kanë mbetur propozimet e shumicës së pranishme në debatet e mbajtura. Në fshatin Dobratin të gjitha lagjet janë për emërimin e një rruge Haki Rekalii, i cili është vrarë gjatë luftës, mirëpo kjo nuk është marrë në konsideratë e këtë e rëndon edhe më tepër fakti se tri kode të rrugëve janë propozuar të emërohen me emra livadhesh e qeshmësh. Për këtë çështje në formë të shkruar me nënshkrime të qytetarëve është njoftuar edhe Komisioni përkatës, andaj për mua është e pakuptimtë përse nuk është marrë në konsideratë kërkesa e komunitetit të cekur. Lidhur me këtë propozim im është të hiqet emërtimi i një rruge me emër livadhesh apo të gjendet ndonjë zgjidhje tjetër në mënyrë që të përmbushet kërkesa e atyre qytetarëve.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, për debate me qytetarë në Bashkësitë e fshatrave paraprakisht janë bërë njoftimet publike në të gjitha fshatrat si dhe përmes radiove lokale dhe të gjithë qytetarët e interesuar, pa dallim të përkatësisë partiake, kanë marrë pjesë në debate dhe i kanë bërë propozimet sipas vullnetit të tyre. Në disa mjedise siç është Dumnica, Sfeçla etj. debatet janë mbajtur në tri salla ngase interesimi i qytetarëve ka qenë mjaftë i madh. Gjatë debateve nuk janë marrë të gjitha propozimet dhe në funksion të kësaj janë bërë edhe propozime nga takimet e përfaqësuesve të fshatrave me komunitetin lokal, propozime me nënshkrime të qytetarëve përkatës por ka pasë edhe propozime individuale e që Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha propozimet e arritura

Përndryshe përfundoi kryesuesi, për të qenë më efektiv është mirë që pas çdo propozimi të votohet në mënyrë që të përcaktohem për ndryshimet për të cilat pajtohem.

z. Fidan Rekalii, theksoi, pajtohem me propozimin e z. Rafet Llapashticës, mirëpo duhet të kemi kujdes edhe për propozimet e bëra nga qytetarët e Dobratinit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, fshati Dobratin përbëhet prej 10 – 12 lagjeve dhe përfaqësuesit e të gjitha lagjeve, përveç lagjes Dervisholli, janë që rruga me emërtim Haki Rekaliu të emërtohet në vendin ku i ndjeri është vvarë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Komisioni për propozimin e emërimit të rrugëve, propozimet i ka marrë në debatet me qytetarë, tubime në të cilat diku kishte pjesëmarrës më shumë e diku më pak, pastaj propozimet janë bërë në formë të shkruar në mënyrë grupore dhe individuale.

Sa i përket propozimit të parafolësit jam i mendimit se i njëjti duhet të mbështetet dhe mënyra më e lehtë për zgjidhjen e kësaj çështjeje është që të hiqet emërtimi i ndonjë livadhi apo qeshme dhe të bëhet zgjidhja e mundshme.

Konsideroj se duhet të kemi kujdes dhe të sqarojmë një çështje e ajo është se kemi emërtime të rrugëve me emër dhe mbiemër të njëjtë të dy personave të vdekur apo me emër dhe mbiemër të njëjtë të një personi të vdekur dhe një personi i cili ende është në jetë, siç janë rastet: Emin Berisha, Jahir Gashi, Ajet Berisha, Xhavit Hasani, Vehbi Kikaj etj., andaj me qëllim që të shmangim çfarëdo paqartësie dhe të bëhet identifikimi i plotë, konsideroj se është e nevojshme që në raste të këtilla të shkruhen edhe inicialet e emrit të prindit.

z. Afrim Shabani, theksoi, emri i Dëshmorit Ismet Dërguti, i cili ka rënë te Tabet e Llapashticës është propozuar për një rrugë në fshatin Obrançë, lidhur me këtë jam i interesuar të di se çfarë lidhje ka ky Dëshmor me fshatin Obrançë kur dihet se i njëjti ka qenë me prejardhje nga fshati Barainë dhe ka jetuar në Podujevë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në funksion të punës më efikase është mirë që të bëhen propozimet konkrete dhe menjëherë propozimi të vihet në votim dhe në këtë mënyrë të vazhdohet deri në fund.

z. Kumrie Hoti, theksoi, në debatin e mbajtur me qytetarë në fshatin Revuç, rruga me kodin 10790 është propozuar emërtimi Avdyl Januzi, mirëpo në material shihet se propozimi për emërtimin e rrugës së cekur është Zahir Uka, sipas mendimit tim në rastin konkret është ndonjë keqkuptim e për këtë ka pasë edhe ankesa të qytetarëve.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, në vazhdimësi ka pasë ankesa e në veçanti në tri ditët e fundit janë paraqitur disa ankesa në formë të shkruar por edhe në formë gojore.

Pajtohem me propozimin e z. Rafet Llapashtica që rruga me emërtimin e qeshmës të emërtohet Haki Rekaliu. Rruga me të cilën është propozuar emërtimi Ismet Dërguti gjendet te rrethrotullimi mirëpo ajo evidentohet në Zonën Kadastrale Obrançë. Sa i përket fshatit Revuç, është e vërtet se në debatin me qytetarë është propozuar emri Avdyl Januzi, mirëpo ditë më parë bashkërisht me përfaqësues të dy lagjeve kemi arritur një kompromis, me kërkesë të protokoluar që t'i përcillet Komitetit për Politikë dhe Financa, që rruga me kodin 10824 të hiqet emërtimi Fisi i Hotit dhe të emërtohet Zahir Uka.

z. Haki Rudari, theksoi, Komisioni për propozimin e emërtimeve të rrugëve ka bërë një punë mjaftë të vështirë dhe të ndjeshme, mirëpo sipas mendimit tim ne është dashur që fillimisht t'i kemi kriteret ngase sikur t'i kishim kriteret puna do të ishte shumë më e lehtë. Këtë e them ngase në listën rezervë po i shoh emërtimet Brukseli, Barcelona etj. e sikur t'i kishim kriteret këto emërtime nuk do të propozoheshin fare.

Rruga në Kunushec, kodi 10594 është propozuar emërtimi Emin Berisha, i ndjeri ka qenë inxhinier, pastaj rruga në Shajkoc, kodi 10374 është propozuar Muharrem Rudari i cili ka qenë luftëtarë i Luftës Nacional Çlirimtare në vitin 1945. andaj do të ishte mirë që në raste të këtilla të plotësohet me inicialen e emrit të prindit apo me profesionin që ka pasë.

z. Naim Çunaku, theksoi, Komisioni për propozimin e rrugëve vërtetë ka pasë një punë të vështirë në veçanti duke pasë parasysh numrin e madh të rrugëve por edhe faktin se për ne disa propozime nuk kanë qenë në rregull ngase përveç propozimeve meritore, janë edhe propozime jo meritore, emra të gjyshëve dhe stërgjyshëve dhe kjo në një formë Komisionit i ka krijuar probleme. Në këtë debat po përmenden disa çështje por të jeni të bindur se Komisioni i ka mbajtur afro 70 takime dhe çështjet të cilat u shtruan gjatë këtij debati por shumë e shumë çështje të tjera janë shqyrtuar dhe trajtuar në të gjitha aspektet, andaj nuk pretendoj se para jush e kemi sjellë një dokument të përkryer por të paktën konsiderojmë se afro 70% e propozimeve janë në rregull.

Konsideroj se edhe në këtë material do duhej të bëhen disa ndryshime dhe atë: në fshatin Llugë kodi i rrugës 18_11004, propozimi i emërimit është Agim Bulliqi, Dëshmor, i cili në mesin e qytetarëve njihet me këtë emër, por në realitet sipas dokumentacionit përkatës ai ka qenë Muhamet Bulliqi.

Në fshatin Shakovicë kodi 18_10645 të zëvendësohet nga emri Latif Kovaqi, të zëvendësohet me emrin Burimi Termal.

U përmenden disa emërtime të rrugëve ku emrit dhe mbiemrit duhet t'i shtohet edhe iniciali i prindit, në këtë kontekst propozoj që përveç rasteve të përmendura kjo çështje të përfshihet edhe më gjerë ngase në listë ka emërtime të cilave domosdo duhet shtuar iniciali i prindit, shembull në listë e kemi emërtimin e një rruge Mehmet Gashi, e që Mehmet Gashi është kryesues i këtij Komiteti përkatësisht kryesues i Kuvendit të Komunës, andaj këto plotësime janë të nevojshme në mënyrë që të hiqen këto dilema.

Lidhur me emërtimet e listës rezervë, në komision jemi pajtuar që të merren emërime nga historia e trojeve shqiptare, mirëpo në listën rezervë i vërejtja disa emërtime që sipas mendimit tim nuk janë me vend siç janë: Sokolat, Sillosi, Shpatina, Pagëzimi, Livadhet e Vogla, Klisura, Galaktika, Bilbilat, Barcelona, vazhdoi duke lexuar edhe emërtime të tjera dhe shtoi, lidhur me këtë kam emërtime konkrete dhe propozoj që të ndryshohen si vijon: Prenk Jakova, Drithniku, Faik Konica, Pjetër Budi, Haxhi Zeka, Xhfer Deva etj.

Kruesuesi z. Mehmet Gashi, propozoi që të fillohet me vërejtjet e Agjencionit Kadastral të Kosovës të bëra në listën e emërtimeve të propozuara e pastaj të paraqiten vërejtjet dhe plotësimet e anëtarëve të këtij Komiteti, por pas çdo propozimi dhe arsyesimit përkatës të votohet dhe të vendoset emërtimi konkret.

Në vazhdim, pas paraqitjes së vërejtjeve, propozimeve, dialogjeve dhe sqarimeve, si dhe votimit veç e veç për çdo propozim, u konstatua se kuvendit njëzëri i rekomandohet shqyrtimi i propozimit të Vendimit për emërtimin e rrugëve, me ndryshime në Listën emërtimeve të propozuar, si vijon:

- Të bëhet korrigjimi drejtshkrimor në gjithë listën e emërtimeve.

Ndërsa,

-Rruga me kodin 18_10627, prej Vllaznia Surdulli të emërtohet Vëllezërit Surdulli

-Rruga me kodin 18_10826, prej Masakra e Shtatorit të emërtohet Haki Rekalii

- Rruga me kodin 18_13211, prej Haki Rekalii të emërtohet Maksut Rekalii
- Rruga me kodin 18_11209, prej Lufta e Merdarit të emërtohet Xhavit Haziri
- Rruga me kodin 18_10219, prej Bulevardi i Pavarësisë të emërtohet Besa e Pavarësisë
- Rruga me kodin 18_10159, prej Bajram Shala të emërtohet Bajram Popova
- Rruga me kodin 18_11163, prej Vëllezërit Graniti të emërtohet Vëllezërit Blakçori
- Rruga me kodin 18_11131, prej Kroi i Letancit të emërtohet Dëshmorët e Fshatit
- Rruga me kodin 18_10775, dhe 18_10169 e kanë emërtimin e njëjtë Salih Hoxha dhe Korrigjohet, 18_10775 të mbetet Sali Hoxha, ndërsa 18_10169 të emërtohet Salih Turuqica
- Rrugët kodin 18_10514 dhe kodi 18_10081e kanë emërtimin e njëjtë Besnik Shabani dhe korrigjohet, Kodi 18_10514 mbetet Besnik Shabani ndërsa kodi 18_10081 të emërtohet Adem Podjeva
- Rrugët me kodin 18_11221 dhe 18_10098 e kanë emërtimin e njëjtë Brahë Hertica, të korrigjohen 18_11221 të emërtohet Fadil Talla ndërsa kodi 18_10098 mbetet Brahë Hertica
- Rruga me kodin 18_12322 kod i ri të emërtohet Beqir Kastrati
- Rruga me kodin 18_10410, prej Mehmet Rexha të emërtohet Mrizi i Prehjes
- Rruga me kodin 18_10195, prej Bajram Ajvazi të emërtohet Ahmet Popova
- Rruga me kodin 18_10473, prej Likeni, të emërtohet Bajram Ajvazi
- Rruga me kodin 18_10512, prej Ded Gjo Luli të emërtohet Imer Shabani
- Rruga me kodin 18_10038, prej Dëshmorët Babatinca e Stublla të emërtohet Dëshmorët Babatinca
- Rruga me kodin 18_10290, prej Faik Konica të emërtohet Dëshmorët Stublla
- Rruga me kodin 18_10790, me emërtim Zahir Uka, ndahet në dy pjesë dhe krijohet kodi i ri, kodi 18_10790 të emërtohet Abdyl Januzi ndërsa kodi i ri 18_12002 të emërtohet Zahir Uka
- Rruga me kodin 18_10675, prej Qazim Bajraktari të emërtohet Emin Aga
- Rruga me kodin 18_10427, prej Livadhi i Behramit të emërtohet Emin Dushkolli
- Rruga me kodin 18_10985, prej Mësuesi të emërtohet në shumës Mësuesit
- Rruga me kodin 18_10645, prej Latif Kovaci të emërtohet Burimi Termal
- Rruga me kodin 18_11004, prej Agim Bulliqi të emërtohet Muhamet Bulliqi
- Rruga me kodin 18_10210, prej Adem Podjeva të emërtohet Met Podjeva.

- Emërtimet me emër dhe mbiemër, me qëllim të identifikimit të saktë, të plotësohen me inicialen e prindërit, si vijon:

Emërtimi i rrugës në Batllavë, Enver Maloku, të plotësohet Enver M. Maloku
 Emërtimi i rrugës në Kunushec, Emin Berisha, të plotësohet Emin R. Berisha
 Emërtimi i rrugës në Dobërdol, Qelë Gashi, të plotësohet Qelë L. Gashi
 Emërtimi i rrugës në Shajkoc, Muharrem Rudari, të plotësohet, Muharrem S.Rudari
 Emërtimi i rrugës në Kunushec, Fazli Kunushefci, të plotësohet Fazli R. Kunushefci
 Emërtimi i rrugës në Lupç të Poshtëm, Vehbi Kika, të plotësohet Vehbi D. Kikaj
 Emërtimi i rrugës në Kunushec, Emin Kunushefci, të plotësohet Emin ___Kunushefci
 Emërtimi i rrugës në Livadicë, Xhavit Hasani, të plotësohet Xhavit ___ Hasani
 Emërtimi i rrugës në Bajqinë, Jahir Gashi, të plotësohet Jahir ___ Gashi

Emërtimi i rrugës në Kunushec, Ajet Berisha, të plotësohet Ajet____ Berisha
- Gjithashtu sipas nevojës të plotësohen edhe emërtime tjera të ngjashme varësisht nevojave.

Komitetit për Politikë dhe Financa, njëzëri ngriti Komision për rishikimin e listës me emra rezervë, dhe të gjithë emrave të propozuar për emërtimin e rrugëve, në këtë përbërje:

z. Mehmet Gashi, z. Naim Çunaku, z. Lutfi Rexhepi, z. Adem Ajvazi dhe z. Bahri Selimi

Komisioni më 03 shkurt 2015 mbajti takimin ku njëzëri i rekomandoi Kuvendit të Komunës, që:

- Rruga me kodin 18_11007, prej Avni Ramadani të emërtohet Sylë Durmishi
- Rruga me kodin 18_11016, prej Ali Pashë Tepelena të emërtohet Avni Ramadani
- Rruga me kodin 18_10072, prej Asdreni të emërtohet Universi
- Rruga me kodin 18_11132, prej Florida të emërtohet Enver Rr Maloku
- Rruga me kodin 18_11022, prej Shtojzavalle të emërtohet Ura e Trenit

Po ashtu komisioni i cekur përgatiti edhe listën me emrat rezervë e cila është pjesë përbërëse e këtij materiali.

5. Propozimi i Programit trevjeçar të banimit 2015-2017, në Komunën e Podujevës

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në këtë material janë disa të dhëna me të cilat nuk mund të pajtohem, kjo ka të bëjë me të dhënat për komunitetet tjera ngase për këtë janë marrë shënimet e paraluftës, shembull mund ta marr fshatin Bellopojë ku ka qenë një malazez i cili ka vdekur te vajza e tij në Graçanicë, por të dhëna të këtilla ka edhe për fshatra të tjera.

z. Agron Hyseni, theksoi, ky material është punuar në procedurë të përsheptuar dhe afati i dërgimit në Ministrinë përkatëse është 5 shkurt 2015, mirëpo pajtohem me parafolësin që të dhënat e cekura të korrigjohen.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në material figuron se në disa fshatra siç është rasti i Bajqinës jetojnë komunitete tjera, kjo nuk është e vërtetë dhe këto të dhëna duhet të korrigjohen. Gjithashtu thuhet se në Komunën e Podujevës, para vitit 1990 numri i popullsisë ka qenë 126.000 banorë, kjo nuk qëndron dhe duhet korrigjuar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jemi në dijeni se është bërë regjistrimi i fundit i popullsisë andaj ekzistojnë të dhënat zyrtare të cilave domosdo duhet referuar. Të dhënat e vitit 1990 nuk mund të merren për bazë ngase një pjesë e komuniteteve pakicë kanë qenë kolonë të ardhur nga vatrata e ndryshme të luftërave të atëhershme.

z. Haki Rudari, theksoi, regjistrimi i popullsisë është bërë në vitin 2011 nga Enti Statistikor i Republikës së Kosovës, andaj të dhënat për numrin e komuniteteve të tjera janë shqetësuese. Përndryshe regjistrimi i popullsisë në vitin 1990 nuk është

pranuar nga organet e Kosovës dhe ato të dhëna nuk mund të merren si të qëndrueshme.

Pas votimit u konstatua se Programi... Kuvendit njëzëri rekomandohet për shqyrtim me korrigjim që të dhënat të jenë konform regjistrimit të fundit të popullsisë, duke përfshirë edhe të dhënat për komunitetet jo shumicë

6. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ-në HANDIKOS – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë

z. Haki Rudari, theksoi, realisht ky propozim po më duket jo në rregull ngase kur Grupi i këshilltarëve i LVV – së ka propozuar që lehonat të ndihmohen në mënyrë financiare, shumica e këshilltarëve kanë thënë se nuk ka buxhet dhe se ajo çështje nuk mund të shqyrtohet deri në rishikimin e buxhetit, ndërsa tash përnjëherë del kërkesa për mbështetje financiare mbi 14.000 €. Përndryshe në parim e mbështes këtë propozim por mospajtimi im ka të bëjë me atë se kërkesa e mëhershme nuk është marrë fare në konsideratë nga ana e Ekzekutivit.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, Komuna e Hanit të Elezit është e vetmja komunë e cila subvencionon lehonat, por ajo komunë i ka afërsisht 9.960 banorë, dhe subvencionimin e lehonave e bënë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë vjetore prej 15.000 € deri 20.000 €, mirëpo ne nuk kemi mundësi ngase nëse llogaritet në mënyrë lineare shuma do të arrij afërsisht 150.000 € brenda një viti, mjete të cilat nuk kemi mundësi t'i sigurojmë.

Sa i përket propozimit të këtij vendimi mund të them se kategorisë përkatëse, mbi bazën e kërkesës së tyre, në vazhdimësi i kemi ndihmuar me qëllim që kjo OJQ t'i zhvilloj aktivitetet më elementare e që ka të bëjë me kategorinë më të ndjeshme të shoqërisë.

z. Fidan Rekalii, theksoi, natyrisht se e mbështesim propozimin e këtij vendimi duke u bazuar se kjo është kategoria më e veçantë e shoqërisë.

z. Kumrie Hoti, theksoi, propozimi i këtij vendimi është më se i mirëseardhur por konsideroj se në vazhdimësi duhet angazhuar që të identifikohen të gjitha rastet e personave me nevoja të veçanta në mënyrë që të mos mbetet ndokush pa përfituar ndihmën e mundshme po e zëmë ndonjë karrocë apo ndonjë pajisje tjetër.

z. Agron Hyseni, theksoi, aktiviteti i kësaj OJQ – je përfshin edhe hulumtimin dhe identifikimin e rasteve të reja dhe në bazë të këtij aktiviteti për çdo vit rritet numri i personave me nevoja të veçanta.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, me 9 vota për dhe 1 votë të përmbajtur i rekomandohet për shqyrtim.

7. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për këtë çështje kuvendi e ka miratuar një vendim, mirëpo ne të gjithë duhet ta kemi të qartë se askujt nuk jemi të obliguar t'ia japim pronën e komunës në shfrytëzim pa kompensim e aq më tepër një kompanie private. Kur e kemi shqyrtuar vendimin paraprak kam qenë për, pavarësisht se për mua ka qenë irelevante se kompensimi për m² a do të jetë 5. € apo 10. €. Mirëpo përgjigjja e KEDS –it se paluajtshmërinë përkatëse nuk mund ta merr në shfrytëzim me kompensim dhe nëse nuk i lejohet pa kompensim do t'i ndërpres investimet, është përgjigje jo e qëndrueshme dhe për këtë ne mundemi edhe ta padisim ngase nuk ka kurrfarë baze të mos investoj për shkak se komuna nuk ia falë tokën. Përndryshe sikur të ishte korporata e mëparshme KEK – u e cila ka qenë shoqërore, kjo do të ishte krejt tjetër, por në rastin konkret kemi të bëjmë me një kompani private e cila i ka përfitimet e veta dhe mbi këtë bazë përkatësisht marrëveshjen e privatizimit është e obliguar të bëjë investimet e nevojshme.

Konsideroj se në bazë të mënyrës së përpilimit, propozimi i këtij vendimi, është jo ligjor ngase për dhënie në shfrytëzim për 99 vite duhet bazuar në një ligj tjetër, por nëse flasim për shfrytëzim afatshkurtër kjo është diçka tjetër.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, e kuptoj parafolësin por duhet të kemi parasysh se KEDS – i nuk do të thotë përse nuk ma lejuat dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë konkrete por mund të gjejmë justifikim e të thotë se tani për tani nuk kemi mundësi të investojmë për sigurimin e trafave por këtë do ta bëjmë pas dy apo tri viteve e me këtë do të pësojnë banorët e fshatrave përkatës.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem plotësisht se nuk është mirë që ne t'i nënshtrohemi shantazheve të KEDS – it kur thotë ose ma jepni paluajtshmërinë në shfrytëzim pa kompensim ose ne tërhiqemi, mirëpo pavarësisht kësaj unë jam për atë që paluajtshmëria përkatëse t'i jepet në shfrytëzim, jo 99 vite por për një periudhë më të shkurtë.

z. Kadri Avdiu, propozoi që KEDS – it paluajtshmëria përkatëse t'i jepet në shfrytëzim për 40 vite.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, propozimi i këtij vendimi është përgatitur plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 12 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nen i cili parasheh rastet e veçanta të dhënies së pronës në shfrytëzim, se a do të jepet me kompensim apo pa kompensim për këtë vendos Kuvendi i Komunës. Përndryshe me këtë nuk i bëjmë favore KEDS – it por qytetarëve tanë ngase prej tyre kemi kërkesa të kësaj natyre në vazhdimësi.

z. Bahri Blakçori, theksoi, në fshatin Letancë para dy javëve është djegur trafaja, është vendosur një e përkohshme mirëpo duke u bazuar se numri i shtëpive në fshat është rritur, tash shtrohet nevoja të vendoset një trafo më e madhe në mënyrë që furnizimi me energji elektrike të jetë i rregullt.

Pas votimit u konstatua se me 9 vota për dhe 2 vota kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim me propozim që kohëzgjatja e dhënies së pronës në shfrytëzim të jetë 40 vite.

8. Komiteti për Komunitete

- **Raporti i punës për vitin 2014**
- **Plani i punës për vitin 2015**

Kuvendit të Komunës njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.

9. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Sabit Halitit nga Podujeva dhe Muharrem Isufit nga fshati Majac)

Kuvendit të Komunës njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

10. Informatë e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës, lidhur me zhvillimet e proceseve të gjertanishme për ndërtimin e shtëpive në lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc dhe përzgjedhja e familjeve për vendosje në ato shtëpi.

Kuvendit të Komunës njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 15.40'

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-16398
Podujevë,
2 shkurt 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**